



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:290614

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06334643

C.nr. 2224/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florid Hasku dhe me Zyrtarin Ligjor Valdet Delijaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit L. H., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti për kompensim e dëmit material, në seancën përgatitore, me datën 22.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e udhëhequr në shenjën C.nr.2224/21, e paditësit L. H., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi L. H., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, në këtë gjykatë me datë 23.12.2021, nëpërmjet të autorizuarit të tij Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti për kompensimin e dëmit material.

Gjykata me datën 18.09.2024, në fillim nga ora 10:30h, ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, duke ftuar në mënyrë të rregullt palët ndërgjyqëse, mirëpo paditësi edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, nëpërmjet të autorizuarit të tij avokat Arben Biblekaj, ku sipas fletkthesës (*e cila gjendet në shkresat e lëndës*) gjykata ka konstatuar se i autorizuari i paditësit ftesën e ka pranuar me datë 02.08.2024, mirëpo nuk është paraqitur në seancën e caktuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë. Në këtë seancë nuk ka prezantuar as e paditura, edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, ku sipas fletkthesës (*e cila gjendet në shkresat e lëndës*) gjykata ka konstatuar se ftesën e ka pranuar me datë 02.08.2024, mirëpo mospjesëmarrjen në seancën e caktuar dhe mungesën e saj nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 409.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet*”, gjykata ka vepruar duke e konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 409 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2224/21, me datë 22.10.2024

Gj y q t a r i
Florid Hasku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.